



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

---

Numri i lëndës: 2021:090803  
Datë: 17.06.2022  
Numri i dokumentit: 03144202

C.nr.636/2021

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Mirjeta Shala, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësve Sh.S., T.R., dhe A. Z.-M.që te gjithë nga Gjakova, të cilat sipas autorizimit i përfaqëson i Arben Biblekaj, avokat në Prishtinë, rruga “Fehmi Agani” Hy – 25/4, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit, të cilinë e përfaqëson Dardan Bakija, me autorizim, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe të udhëtimit në punë, vlera e kontestit 2,651.10 € pas përfundimit të shqyrtimit kryesor-publik të mbajtur në prezencën e të autorizuarit të paditëseve dhe të autorizuarit të paditurës, me datë mori 06 qershor 2022, mori këtë:

#### A K T G J Y K I M

I. APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditëses A.Z.M. nga Gjakova, dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, që paditëses A.Z. M. nga Gjakova, në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë në punë, për periudhën kohore 01.09.2020 e deri më datë 10.01.2022, për 255 ditë pune, të ia paguajë shumën prej 510.00 euro, si dhe në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit, për periudhën kohore 01.09.2020 e deri më 10.01.2022, për 255 ditë pune, të i’a paguajë shumën prej 821.10 euro, përkatësisht në shumë të përgjithshme prej 1,331.10 Euro, me kamatën ligjore prej 8% duke filluar nga data 11.05.2021 (datë e ushtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarrimit me detyrim.

II. APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditësit Sh. S. nga Gjakova, dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, që paditësit Sh. S. nga Gjakova, në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, për periudhën kohore nga data 14.09.2020 deri me datën 29.04.2022, për 330 ditë të pranisë në punë, të i’a paguajë shumën prej 660.00 euro, me kamatën ligjore prej 8% duke filluar nga data 11.05.2021 (datë e ushtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarrimit me detyrim.

III. APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditësit T. R. nga Gjakova, ashtu që DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, që paditësit T. R. nga Gjakova, në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit për periudhën kohore nga data 14.09.2020 deri me datën 29.04.2022, për 330 ditë të pranisë në pune, të i'au paguajë shumën prej 660,00 euro, me kamatën ligjore prej 8% duke filluar nga data 11.05.2021 (datë e ushtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimin të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarrimit me detyrim.

IV. DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, që paditëseve, në emër të shpenzimeve të procedurës, të i'au paguaj shumën prej 786.00 euro në afatin prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarrimit.

### A r s y e t i m

Paditësit Sh.S., T. R., dhe A. Z-M. që te gjithë nga Gjakova, përmes të autorizuarit të tyre, në këtë gjykatë me datë 11.05.2021, kanë ushtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit për të gjithë paditësit, ndërsa për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit vetëm për paditësen A. Z. M., kjo pasi që të njëjtët janë punëtor të arsimit në SHFMU "B. S. ", në fshatin B., komuna e Gjakovës. I autorizuari i paditësve në seancën e datës 11.05.2022 ka bërë precizimin e kërkesëpadiës në aspektin objektiv. Në sancën e shqyrtimit kryesorë ka deklaruar se sa i përket kompensimit të shujtave ditore përfshirë periudhën 14.09.2020 deri me dt.29.04.2022 për paditësin e parë dhe të dytë, për 330 ditë pune të realizuar secili nga ta, ndërsa për paditësen A. Z.-M., për periudhën kohore nga data 01.09.2020- 10.01.2021, për 255 ditë punë të realizuara. Po ashtu lidhur me këtë paditëse për periudhën e njëjtë kohore, i takojnë edhe kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit pasi që e njëjta për çdo ditë punë për gjatë kësaj periudhe kohore ka udhëtuar nga vendbanimi i saj fshati B. për në Gjakovë e nga aty për në vend punimin e saj në SHFMU "R." në fshatin D., komuna e Gjakovës. Në padinë e precizuar, në fjalën e dhënë në seancën e shqyrtimit kryesorë të çështjes dhe në fjalën e tij përfundimtare, i autorizuari i paditësve ka deklaruar se, kërkesë në raport me shujtën ditore gjen mbështetje edhe në Kontratën e Arsimit të Kosovës, konkretisht kapitulli IV, neni 35, parg. 7, ndërsa parg. 5 i po të njëjtit nen ka rregulluar çështjen e kompensimit të udhëtimit për punëtor të arsimit . Andaj mbi këtë bazë i ka propozuar gjykatës që padia dhe kërkesëpadia e paditësve të aprovohet si e bazuar, ashtu që të detyrohet e paditura që të gjithë paditësve në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, për 330 ditë punë të realizuar nga paditësi i parë dhe i dytë, secilit të ia paguaj nga 660,00€ ndërsa paditëses A.Z.-M.për 225 ditë të pranisë në punë në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit në vlerën e përgjithshme për të dyja kërkesat për ketë paditëse, në lartësi prej 1,331.00 euro, e të gjitha këto shuma për të gjithë me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data e parashtrimit të paditës e deri në pagesën definitive të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarrimit.

Shpenzimet procedurale i ka kërkuar dhe atë: taksën gjyqësore për padi në vlerë prej 20,00 €, për përpilimin e padisë prej 208.00 €, për parashtrësën për precizimin e kërkesë padisë në vlerë prej 104,00 € dhe për përfaqësim në dy seancë gjyqësore nga 270,00 € për secilën seancë, apo në shumën e përgjithshme 786.00 €.

E paditura me përgjigje në padi të parashtruar në gjykatë me datën 08.12.2020 e ka kundërshtuar në tërësi si të pabazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, dhe dukë i propozuar gjykatë që të merr aktgjykim dhe të njëjtën ta refuzojë si të pabazuar. Me te ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar dhe ka propozuar që kërkesëpadia e paditëses të refuzohet. Bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të nënshkruar me datë 18 prill 2017 në mes të Arsim Bajrami ish Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Rrahman Jashari, Kryetar i SBASHK-ut njoftojnë se përkundër nenit 46 të asaj Kontrate, nga ana e MASHT-it dhe SBASHK-ut nuk janë angazhuar dhe ndihmuar Komunat që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe kostos buxhetore për zbatimin e asaj Kontrate në Ministrinë e Financave me qëllim të realizimit të buxhetit. Ka kërkuar që të detyrohet paditësja që të paditurës të ia kompensojë shpenzimet e procedurës dhe atë në kuptim të nenit 452 të LPK-së.

Ndërsa i autorizuari i të paditurës në fjalën e dhënë në seancën e shqyrtimit kryesorë dhe në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se kontrata e kolektive e arsimit në Kosovë e nënshkruar në mes MASHT dhe SBASHK-ut me dt. 22.01.2021, ka shfuqizuar me nenin 47 të saj, ka shfuqizuar Kontratën kolektive të vitit 2017, ashtu edhe sipas nenit 35 par. 5 që ka të bëjë me shpenzimet e rrugës dhe nenit 35 par. 7 që ka të bëjë me shujta, por duke pas parasysh se dispozitat kalimtare në nenin 45 par. 1, akoma nuk është bërë një planifikim i buxhetit dhe kostos financiare për zbatimin e këtyre dispozitave deri sa të krijohen mundësit financiare në buxhetin e R. Kosovës, por jo më vonë se viti 2023. Andaj edhe sipas Qarkores buxhetore 2022/01 i dt. 14.05.2021, të lëshuar nga z. Hekuran Murati Ministër Financave në grandin specifik të arsimit para universitar nuk është e paraparë pagesa e udhëtimit të mëshim dhënësive dhe kompensimit të ushqimit në punë. Lidhur me precizimin e kërkesëpadisë së paditësve, i njëjti ka deklaruar se të njëjtën nuk e kundërshton.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike gjatë shqyrtimit kryesor ka bërë administrimin e provave si në vijim: Kontrata e punës për paditësin Sh. S., e lëshuar nga Komuna e Gjakovë – Drejtoria e Arsimit, në versionin e fotokopjuar, Vërtetimi i lëshuar nga SHFMU “B. S.” fshati B.-Gjakovë me nr.prot.../...i dt. 29.04.2022, Kopja e letërnjoftimit për paditësin Sh. S., Kontrata e punës për paditësin T.R. e lëshuar nga Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit, në versionin e fotokopjuar, Vërtetimi i SHFMU “B. S.” fshati B.-Gjakovë me numër të protokollit ..../... dt.29.04.2022, Kopja e letërnjoftimit për paditësin T. R., Kontrata e punës për paditësen A. Z. M. e lëshuar nga Komuna e Gjakovës-Drejtoria e Arsimit në versionin e fotokopjuar me numër të kontratës ..../....., Vërtetimi i lëshuar nga SHFMU “R.” fshati D.-Gjakovë me numër të protokollit .....të dt.04.05.2022, referuar shpenzimeve të ushqimit, Vërtetimi i lëshuar nga SHFMU “R.” fshati D.-Gjakovë me numër të protokollit .....dt.04.05.2022 referuar shpenzimeve të transportit, Kopje e letërnjoftimit për paditësen A. Z. M., Vërtetimet e lëshuara nga shoqata e transportit të udhëtimeve në Gjakovë, Certifikata e

vendbanimit për paditësen A. Z. M., me numër . nr.ser ..... e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Gjakovë e dt.29.04.2022.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore,( më tutje LPK-së), arriti në përfundim se në këtë çështje juridikë kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga provat e administruara, u vërtetua gjendja faktike si në vijim:

Nga Kontrata e punës për paditësen A. Z. M. e lëshuar nga Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit, me nr. Të kontratës 277/2/2020, provohet fakti se e njëjta është në marrëdhënie pune në Institucionin Arsimor : shkolla “R.” në fshatin D. Komuna e Gjakovës pozita: mësimdhënëse. Vërtetimi i lëshuar nga SHFMU “R.” në D., Nr. Prot..... i datës 04.05.2022, provon faktin se këtu paditësja në institucionin e lartcekur nga data 14.09.2020 – 29.04.2022 ka vijuar 255 ditë pune (referuar kompensimit për shujtë ditore). Vërtetimi i lëshuar nga SHFMU “R.” në D., Nr. Prot..... i datës 04.05.2022, provon faktin se këtu paditësja në institucionin e lartcekur nga data 01.09.2020 – 10.01.2022 ka vijuar 255 ditë pune (referuar kompensimit për shpenzimet e udhëtimit për ditët e pranisë në punë). Vërtetimi i lëshuar nga Shoqata e Transportit të Udhëtarëve provon faktin se çmimi i biletës nga Gjakova në B. në një drejtim është 1.30 euro si dhe nga Gjakova për në fshatin D. në një drejtim kushton 1, 00 euro, ndërsa certifikata e vendbanimit me nr. ...., e lëshuar nga Zyra e Qendrës Civile në Gjakovë, për paditësen A.Z.M. provon faktin se paditësja jeton në F.sh B..

Nga Kontratë pune për paditësin Sh. S. , e lëshuar nga Komuna e Gjakovë – Drejtoria e Arsimit, me kohëzgjatje të kontratës për periudhën kohore nga dt. 01.09.2020 deri më 31.08.2021 është vërtetuar fakti se i njëjti është në marrëdhënie pune në Institucionin Arsimor : shkolla “B. S.” në fshatin B. Komuna e Gjakovës. Vërtetimet e lëshuar nga SHFMU “B. S.” në B., Komuna e Gjakovës, me Nr. prot..... të datës 29.04.2022, provon rrethanën se këtu paditësi punon në institucionin e lartpërmendur që nga viti 2020, i njëjta nga data 14.09.2020 deri me datë 29.04.2022, ka të mbajtura 330 ditë pune.

Nga Kontratë pune për paditësin T.R., e lëshuar nga Komuna e Gjakovë – Drejtoria e Arsimit, me kohëzgjatje të kontratës për periudhën kohore nga dt. 01.09.2020 deri më 31.08.2021 është vërtetuar fakti se i njëjti është në marrëdhënie pune në Institucionin Arsimor :shkolla “B.S.” në fshatin B. Komuna e Gjakovës. Vërtetimet e lëshuar nga SHFMU “B. S.” në B., Komuna e Gjakovës, me Nr. prot..... të datës 29.04.2022, provon rrethanën se këtu paditësi punon në institucionin e lartpërmendur që nga viti 2015, i njëjti nga data 14.09.2020 deri me datë 29.04.2022, ka të mbajtura 330 ditë pune.

Në nenin 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë datë 18.04.2017 dhe Kontratën e datës 22.01.2021, në të cilat në mënyrë të njëjtë është paraparë se: *“Të punësuarve iu njihet e drejta për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të ushqimit për një ditë të pranisë në punë, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie primare të punës në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të*

*punësuarve përmes restaurantit apo kuzhinës, apo ndonjë forme tjetër nuk e ka obligim pagese (2 euro), të te punësuarve për ushqim për t'a bërë kompensimin”.*

Gjykata nga administrimi i provave të cilave prova dhe ja fali besimin e plot, gjeti se paditësit Sh.S., T. R., dhe A. Z.-M., janë në marrëdhënie pune te e paditura, respektivisht në shkollën fillore” B. S.” në fshatin “B.”, komuna e Gjakovës, ndërsa paditësja e tretë edhe në shkollën fillore R.” në fshatin D., komuna e Gjakovës. Paditësi i parë dhe i dytë, për periudhën kohore nga data 14.09.2020 deri me datë 29.04.2022, secili nga ta, ka vijuar nga 330 ditë të pranisë në punë, ndërsa paditësja e tretë për periudhë kohore nga data 01.09.2020 e deri me datën 10.01.2022, ka vijuar 255 ditë të pranisë në punë. Duke u nisur nga fakti se e paditura, paditëseve nuk i’au ka paguar shpenzimet e ushqimit e parapara me dispozita ligjor të lartëcekura, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është e themeltë, andaj në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit bëri përllogaritjen në atë mënyrë që, e ditët e kaluara në punë të paditësve, i ka shumëzuar me 2, duke i’au njohur shumat si në pikën I, II dhe III, të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Sa i përket kërkesës tjetër të paditëses A.Z. M. e cila i referohet shpenzimeve të udhëtimit, gjykata duke u bazuar në provat në të gjitha provat e lartcekura si dhe në nenin 35 par. 5 të Kontratës Kolektive të Arsimit e datës 18.04.2017, me të cilën është paraparë se: *“Mësimdhënësit që udhëtojnë në vendbanimet e Komunës përkatëse ku punojnë u paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”*, nenin 35 par. 5 të Kontratës Kolektive të së datës 22.01.2021, në të cilat në mënyrë të njëjtë është paraparë kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit për punonjësit arsimor, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e precizuar e paditëses A. Z. M. edhe për këtë kriter të kompensimit (të shpenzimeve të udhëtimit) është e themeltë. Kjo pasi që, nga administrimi i provave u vërtetua se paditësja, vendbanimin e ka në fshatin B., provuar sipas certifikata e vendbanimit me nr....., e lëshuar nga Zyra e Qendrës Civile në Gjakovë, ndërsa vend punimet e saj janë në komunën e Gjakovës dhe e njëjta për periudhën data 01.09.2020 deri më 10.01.2022 respektivisht për 255 ditë punë, ka udhëtuar çdo ditë. Lartësinë e kërkesëpadisë për këtë kriter të kompensimit, gjykata e vërtetojë në bazë të vërtetimit të lëshuar nga Shoqata e Transportit në Gjakovë, ku lartësia e çmimit të biletës për relacionin nga vendbanimi i paditë fshati B., për në Gjakovë, e nga aty për në vend punimin e saj në Shkollën Fillore ”R.” në fshatin D., është 4,60 euro për të dy drejtimet. Andaj për 255 ditë pune, e paditura është e detyruar që për këtë kriter të kompensimit, paditëses së lartpërmendur të i’u paguaj vlerën prej 821.10 euro.

Gjykata, me rastin e vendosjes murr parasysh edhe nenin 90 paragrafi 5 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, me të cilin parashihet se: *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*. Sipas neneve të lartë cituara të Kontratë Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë detyrimi i punëdhënësit në rastin konkret i të paditurës për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit e nënshkruar nga Ministria e Arsimit dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e cila prodhon efekt juridik ndaj punëdhënëses të cilët kanë të punësuar punëtorët që të drejtat e tyre burojnë nga ajo kontratë, në rastin konkret

e paditura është punëdhënëse e paditëses dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga ato kontrata.

Sipas nenit 8 par. 1, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës (Ligji nr. 04/L – 077), i publikuar në “Gazetën Zyrtare” të Republikës së Kosovës, nr. 16/2012, datë 19.06.2012 (i cili është në implementim nga data 20.12.2012, është paraparë se: *“Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij”*. Për më tepër dispozita e nenit 245 par. 1 të LMD-së, ka paraparë se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*, prej nga rezulton se debitori, përkatësisht e paditura në rastin konkret është e detyruar që kreditorit, përkatësisht këtu paditësve, të ia paguajë vlerën e precizuar të kërkesëpadisë si dhe shpenzimet tjera aksesore, siç më detajisht është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me kamatëvonesën gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 382 paragrafi 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata, pretendimet e të paditurës se nuk ka planifikim buxhetor për këto kompensime, i gjen si të pa bazuara dhe të pa mbështetura në asnjë normë ligjore të aplikueshme. Paditësja në rrugë gjyqësore ka filluar të realizoj një të drejtë ligjore që i garanton Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë me nr. 01B-2056 e datës 18.04.2017 dhe ajo e viti 2021, kurse mungesa e buxhetit të paditurës, nuk mund të ketë për efekt vendosje ndryshe si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u muar sipas nenit 452 par. 1 të LPK-së, me ç’rast paditëset për udhëheqjen e kësaj procedurë kanë pasur shpenzime të domosdoshme, siç më poshtë vijojnë: në emër të taksës gjyqësore të paguar për padi, shuma prej 20,00 euro, për përpilimin e padisë, shumën prej 208,00 euro, si dhe për pjesëmarrje të autorizuarit të tyre në dy seanca gjyqësore, shumën prej 540.00 euro (270x2) euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 768.00 euro.

Prandaj, gjykata, bazuar ne arsyet e cekura me larte, bazuar ne nenin 143 të LPK-së, vendosi si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË  
Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr.636/2021, me 06 qershor 2022

Gj y q t a r e,  
Mirjeta Shala

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.